

**SHOQËRIA TREGTARE
"4 E -COLOR" SHPK
TIRANË**

**VENDIM NR. 02 datë 13. 07. 2005
I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË TREGTARE
"4 E-COLOR" SHPK**

Në Tiranë, sot në datën 13, muaji Korrik, viti 2005, u mbledh Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve të Shoqërisë Tregtare "4 E-COLOR" SHPK, në selinë e saj, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, të datës 10. 07. 2005 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Autorizuar;

Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve e përbërë nga z. Skënder AGA, z. Erion CUMASHI dhe z. Elsi PECANI, pasi u njoh me rendin e ditës;

VËREN SE

Shoqëria Tregtare "4 E-COLOR" SHPK, është regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 27239 datë 21. 02. 2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Ortakë të kësaj shoqërie, janë z. Skënder AGA, z. Erion CUMASHI dhe z. Elsi PECANI. Kapitali themeltar i nënshkruar i kësaj shoqërie është 100 000 (njëqind mijë) Lekë. Ky kapital është i ndarë në këtë mënyrë:

- a) **Z. Skënder AGA**, zotëron 51 % të kapitalit themeltar të nënshkruar, e barabartë kjo me 51 kuota me vlerën 51 000 Lekë (1 000 Lekë secila kuotë);
- b) **Z. Erion CUMASHI**, zotëron 24,5 % të kapitalit themeltar të nënshkruar, e barabartë kjo me 24,5 kuota, me vlerën 24 500 Lekë (1 000 Lekë secila kuotë)
- c) **Z. Elsi PECANI**, zotëron 24,5 % të kapitalit themeltar të nënshkruar, e barabartë kjo me 24,5 kuota, me vlerën 24 500 Lekë (1 000 Lekë secila kuotë)

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr. 27239/1 datë 06. 07. 2005 ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesës;*
- *Depozitimin në Regjistrimin Tregtar të Vendimit Nr. 01 datë 24. 06. 2005 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të Shoqërisë "4 E -COLOR" SHPK për fillimin e procedurave për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me rezervat dhe fitimet e pashpërndara, gjendje më datë 31. 12. 2004, si dhe caktimin e z. Lavdimir FUSHA, si ekspert kontabël i autorizuar i cili do të hartojë raportin e vlerësimit të zmadhimit të kapitalit;*
- *Të bëhen shënimet përkatëse në kolonat 4 dhe 5 dhe të ndahen regjistrimet me vijë të kuqe nga njëri -tjetri.*

Në vështrim të rendit të ditës, Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve të kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, të datës 10. 07. 2005, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Autorizuar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar. Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve, gjithashtu vëren se z. Lavdimir FUSHA, në detyrën e ngarkuar nga ana e saj, ka punuar me seriozitet, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe etikën e profesionit, gjë e cila vlen për t'u admiruar. Në këtë raport është shprehur dhe menyrja e përcaktimit të numrit të kuotave që do të zotërojë çdo ortak i kesaj shoqërie pas zmadhimit të kapitalit themeltar.

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet nga 100 000 (njëqind mijë) Lekë në 7 900 000 (shtatë milionë e nëntëqind mijë) Lekë, e barabartë kjo me 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 79 000 (shtatëdhjetë e nëntë mijë) Lekë.

Ky kapital do të zotërohet nga ortakët në këtë mënyrë:

SHOQËRIA TREGTARE
"4 E -COLOR" SHPK
TIRANË

- Z. Skënder AGA**, do të zotërojë 51 (pesëdhjetë e një) pjesë kapitali e barabartë kjo me vlerën e 4 029 000 (katër milionë e njëzet e nëntë mijë) Lekësh duke qenë kështu 51 % zotëruesi i kuotave të kapitalit;
- b) **Z. Erion CUMASHI** do të zotërojë 24,5 (njëzet e katër presje pesë) pjesë kapitali e barabartë kjo me vlerën e 1 935 500 (një milionë e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë) Lekësh duke qenë kështu 24,5 % zotëruese e kuotave të kapitalit;
- c) **Z. Elsi PECANI** do të zotërojë 24,5 (njëzet e katër presje pesë) pjesë kapitali e barabartë kjo me vlerën e 1 935 500 (një milionë e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë) Lekësh duke qenë kështu 24,5 % zotëruese e kuotave të kapitalit;

Për këto arsye, Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve, me votim unanim;

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit për Vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë të datës 10. 07. 2005, përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Autorizuar;
2. Zmadhimi i Kapitalit Themeltar të nënshkruar të kësaj shoqërie nga 100 000 (njëqind mijë) Lekë në 7 900 000 (shtatë milionë e nëntëqind mijë) Lekë;
3. Numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit, mbetet i pandryshueshëm, dhe vetëm vlera e tyre rritet;
4. Vlera e çdo kuote (pjesë) kapitali, kalon nga 1 000 (një mijë) Lekë në 79 000 (shtatëdhjetë e nëntë mijë) Lekë;
5. Zotërimi i kapitalit nga ortakët të jetë në këtë mënyrë:
 - a) **Z. Skënder AGA**, do të zotërojë 51 (pesëdhjetë e një) pjesë kapitali e barabartë kjo me vlerën e 4 029 000 (katër milionë e njëzet e nëntë mijë) Lekësh duke qenë kështu 51 % zotëruesi i kuotave të kapitalit;
 - b) **Z. Erion CUMASHI** do të zotërojë 24,5 (njëzet e katër presje pesë) pjesë kapitali e barabartë kjo me vlerën e 1 935 500 (një milionë e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë) Lekësh duke qenë kështu 24,5 % zotëruese e kuotave të kapitalit;
 - c) **Z. Elsi PECANI** do të zotërojë 24,5 (njëzet e katër presje pesë) pjesë kapitali e barabartë kjo me vlerën e 1 935 500 (një milionë e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë) Lekësh duke qenë kështu 24,5 % zotëruese e kuotave të kapitalit;
6. Depozitimi i këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë TIRANË

**ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME
E SHOQËRISË TREGTARE
"4 E-COLOR" SHPK**

Z. Skënder AGA

Skender Aga
[Signature]

Z. Erion CUMASHI

Erion Cumashi
[Signature]

z. Elsi PECANI

Elsi Pecani

[Signature]

